



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 18, datë 08.07.2025

PËR

**REVOKIMIN E LEJES SË MIRATUAR NGA KBU DRIN-BUNË ME
VENDIMIN NR.45, DATË 13.03.2013 “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJITIK, NËPËRMJET
HEC “CURRAJ 4” TË SUBJEKTIT “TELEMANIA-ALB” SH.P.K**

Bazuar në shkronjën “d”, të nenit 146, të ligjit nr.29/2024, “Për burimet ujore”, si dhe në pikën 7, të kreut V, të Vendimit Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Zyrës së Aministrimit të Basenit Lumor Drin-Bunë, Këshilli i Basenit Lumor Drin-Bunë;

V E N D O S I:

1. Revokimin e lejes së miratuar nga KBU Drin-Bunë me vendimin nr.45, datë 13.03.2013 “Për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike, nëpërmjet HEC “CURRAJ 4”, subjektit “TELEMANIA-ALB” sh.p.k, me vendndodhje: Lumi Curraj, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.
2. Ngarkohet Zyra e Aministrimit të Basenit Lumor Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

